

VENDIM
Nr.543, datë 27.7.2016

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE NË FUNKSION TË REALIZIMIT
TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “NEW BORN”¹**

(Ndryshuar me VKM nr.393, datë 3.5.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Neë Born”, Hamallaj, gjiri i Lalëzit, i cili ka përfutur statusin e investimit strategjik, procedurë e asistuar, me vendimin nr.1/15, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

2. Afati për përdorimin e brigjeve, sipas këtij vendimi, të jetë 20 (njëzet) vite duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.1 Bashkia Durrës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “Mane TCI”, lidh kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar nga vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike.

2.2. Së bashku me kërkesën, investitori strategjik “Mane TCI” duhet të paraqesë pranë Bashkisë Durrës edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ekstrakt të 3 muajve të fundit nga Qendra Kombëtare e Biznesit;*
- Planvendosje të sipërfaqes për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e qeverisjes vendore;*
- Përshkrim të aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.*

3. Përdorimi i brigjeve të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror 15 maj - 30 shtator të çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës. Kjo tarifë të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen, objekt kontrate, sipas pikave 2.1 dhe 2.2, më sipër, të lidhur me Bashkinë Durrës, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Durrës.

5. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik “Mane TCI”, me NIPT/NUIS K22203004A, koordinatat, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në përcaktimet e bëra në vendimin nr. 1/15, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike, dhe në përcaktimet e kontratës përkatëse që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Durrës.

6. Ngarkohet Bashkia Durrës për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik në zbatim të këtij vendimi. Në këtë kontratë parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimit e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimit e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ VKM nr.543, datë 27.7.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.145/2016, 3 gusht.
VKM nr.393, datë 3.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.105/2017, 11 maj.